

## Cështja C-13/05

Sonia Chacón Navas

kundër

**Eurest Colectividades SA**

(Referencë për një vendim paraprak nga Juzgado de lo Social n° 33 de Madrid)

(Direktiva 2000/78/EC — Trajtim i brabartë në punësim dhe profesion  
— Koncepti i paaftësisë)

Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Geelhoed i dhënë më 16 mars 2006 . . . . 1 - 6471

Gjykim i Gjykatës (Dhoma e Madhe), 11 korrik 2006 ..... 1 - 6488

### **Përmbledhje e Aktgjykimit**

1. *Vendime paraprake — Juridiksioni i Gjykatës — Limitet (Nen. 234 EC)*
2. *Politika sociale — Trajtim i barabartë në punësim dhe profesion — Direktiva 2000/78 (Direktiva e Këshillit 2000/78, Nen. 1)*
3. *Politika sociale — Trajtim i barabartë në punësim dhe profesion — Direktiva 2000/78 (Direktiva e Këshillit 2000/78, Nen. 2(1) and 3(1)(c))*
4. *Politika sociale — Trajtim i barabartë në punësim dhe profesion — Direktiva 2000/78 (Direktiva e Këshillit 2000/78, Nen. 1)*

1. Në procedurat sipas Nenit 234 KE, të cilat bazhen në një ndarje të vecantë të funksioneve ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Gjykatës së Drejtësisë, cdo vlerësim i fakteve për rastin është çështje që i përket gjykatës kombëtare. Në të njëjtën mënyrë, i takon vetëm gjykatës kombëtare, përpara së cilës është sjellë mosmarrëveshja, dhe e cila duhet të ndërmarrë përgjegjësi për vendimin gjyqësor pasues, të përcaktojë bazuar në rrethanat e çështjes si nevojën për një vendim paraprak për të mundësuar dhënien e gjykimit ashtu edhe rëndësinë e çështjeve që ajo ia paraqet Gjykatës. Rrjedhimisht, ku çështjet e paraqitura kanë të bëjnë me interpretimin e legjislacionit të Komunitetit, Gjykata në parim ka detyrimin të japë një vendim.

Pavarësisht kësaj, në rrethana të jashtëzakonshme, gjykata mund të vlerësojë kushtet në të cilat çështja i është referuar asaj nga gjykata kombëtare, me qëllim për të konfirmuar juridiksionin e vet. Gjykata mund të refuzojë dhënien e vendimit mbi një çështje të referuar për një vendim paraprak nga një gjykatë kombëtare vetëm në ato raste ku është e dukshme që interpretimi i legjislacionit të Komunitetit nuk ka lidhje me faktet aktuale të veprimit kryesor ose qëllimit të tij, ku problemi është hipotetik, ose ku Gjykata nuk ka përpara saj materiale faktike apo ligjore të nevojshme për të dhënë një përgjigje të duhur të çështjeve të paraqitura asaj.

(shih paragrafët 32, 33)

2. Një person i pushuar nga punëdhënësi i tij vetëm për arsye sëmundjeje, nuk bie brenda kuadrit të përgjithshëm të përcaktuar për luftën kundër diskriminimit mbi bazën e aftësisë së kufizuar sipas Direktivës 2000/78 e cila përcakton kuadrin e përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion.

Edhe pse koncepti "aftësi e kufizuar" brenda kuptimit të Direktivës 2000/78 duhet të kuptohet se i referohet një kufizimi që rezulton në mënyrë të veçantë nga dëmtime fizike, mendore apo psikologjike dhe që pengon pjesëmarrjen e personit në fjalë në jetën profesionale, konceptet "aftësi e kufizuar" dhe "sëmundje" nuk mund thjesht të trajtohen si të ishin e njëjta gjë. Duke përdorur konceptin "aftësi e kufizuar" në Nenin 1 të kësaj Direktive, legjislatura qëllimisht zgjodhi një term që ndryshon nga termi 'sëmundje'.

Për më tepër, rëndësia që legjislatura e Komunitetit i jep masave për përshtatjen e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar tregon se parashikon situatat në të cilat pjesëmarrja në jetën profesionale pengohet për një periudhë të gjatë kohore. Në mënyrë që kufizimi të bie në kuadër të konceptit "aftësi e kufizuar", mund të jetë e mundshme që të zgjasë për një kohë të gjatë.

Në çdo rast, asgjë në Direktivën 2000/78 nuk sugjeron se punëtorët mbrohen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar në rast sëmundjeje.

(shih paragrafët 43-47, pjesa operative)

3. Ndalimi, përsa i përket pushimit nga puna, i diskriminimit mbi bazën e aftësisë së kufizuar i përmbajtur në Nenin 2(1) dhe 3(1)(c) të Direktivës 2000/78 e cila përcakton një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion përjashton pushimin nga puna në bazë të aftësisë së kufizuar i cili, në dritën e detyrimit për të ofruar akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, nuk justifikohet nga fakti se personi në fjalë nuk është kompetent, i aftë dhe në dispozicion për të kryer funksionet thelbësore të postit të tij.

(shih paragrafët 51, pjesa operative 2)

4. Sëmundja, si e tillë nuk mund të konsiderohet si bazë përveç atyre në lidhje me të cilat Direktiva 2000/78 e cila përcakton një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion, ndalon diskriminimin

Asnjë dispozitë e Marrëveshjes nuk ndalon diskriminimin mbi bazë të sëmundjes si e tillë. Përsa i përket parimit të përgjithshëm të mos-diskriminimit, ai parim është detyrues mbi Shtetet Anëtare ku gjendja kombëtare në fjalë në procedurat kryesore bie brenda fushëveprimit të legjislacionit të Komunitetit. Megjithatë, nga kjo nuk del që

fushëveprimi i Direktivës 2000/78 duhet të zgjatet me analogji përtej diskriminimit të bazuar mbi baza të listuara në Nenin 1 më sipër.

(shih paragrafët 54, 56, 57, pjesa operative 3)